



Në bazë të nenit 47, paragrafit (1), pikës 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 110/21) dhe neni 124, paragrafi (7) dhe neni 125, paragrafi (3) të Ligjit të Shërbimeve Pagesore dhe të Sistemeve Pagesore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 90/22), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

VENDIM
për përcaktimin e kërkesave për autentifikim të përforcuar
dhe
standarde të përgjithshme, të sigurt dhe të hapura të komunikimit

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim më detajisht përshkruhen :

- kërkesat për autentifikim të përforcuar mes ofruesëve të shërbimeve pagesore të cilët i mirëmbajnë llogaritë pagesore, ofruesit e shërbimeve për inicim të pagesave, ofruesit e shërbimeve për dhënie të informacioneve për llogaritë pagesore, pagesëve, pranuesëve dhe ofruesëve tjerë të shërbimeve pagesore për qëllimet e identifikimit, autentifikimit, njoftimit dhe informimit, mbrojtje të konfidencialitetit dhe integritetit të kredencialeve të sigurisë së klientit, si dhe përjashtime nga aplikimi i kërkesave për autentifikim të përforcuar, dhe
- standardet e lidhjes dhe komunikimit të sigurt të cilat duhet të zbatohen gjatë lidhjes së ofruesit të shërbimeve pagesore e cila mban llogari pagesore dhe mundëson qasje deri te ajo, direkt, onlajn, me ofruesit e shërbimeve pagesore për dhënie të informacioneve të llogarive pagesore, ofruesëve të shërbimeve për inicim të pagesave dhe ofruesëve të shërbimeve pagesore, gjatë transaksioneve pagesore të bazuara në kartela, si dhe kushtet mbi të cilat Banka Popullore mund të mundësojë zbatim të lehtësuar të standardeve për vazhdueshmëri (kontinuitet).

2. Shprehjet e caktuara të përdorura në këtë vendim e kanë kuptimin si vijon:

- **"Certifikatë e kualifikuar e shtypit elektronik"** është vërtetim i shtypit elektronik i lëshuar nga ofrues i shërbimeve konfidenciale të kualifikuara, që i plotëson kushtet e përshkruara me Ligjin e Dokumenteve Elektronike, Identifikim Elektronik dhe Shërbime Konfidenciale dhe të cilat kanë të bëjnë me certifikatin e kualifikuar të shtypit elektronik.
- **"Ridrejtimit i procedurës së autentifikimit"** (ang. redirection) është metodë në të cilën vërtetimi i identitetit të përdoruesit të shërbimeve pagesore ndaj ofruesëve të shërbimeve për dhënie të informacioneve të llogarive pagesore dhe ofruesëve të shërbimeve të cilët inicojnë pagesa në mënyrë automatike ridrejtohen drejt



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

infrastrukturës (faqes së internetit ose aplikacionit) së ofruesit të shërbimeve pagesore i cili i mban llogaritë pagesore për futje të kredencialeve të sigurisë së përdoruesit.

- **“Shkëputja e procedurës së autentifikimit”** (ang. decoupled) është metodë në të cilën vërtetimi i identitetit të përdoruesit të shërbimeve pagesore ndaj ofruesëve të shërbimeve për dhënie të informacioneve të llogarive pagesore dhe ofruesëve të shërbimeve të cilët inicojnë pagesa në mënyrë automatike ridrejtohen në kanal tjetër të komunikimit i lidhur me infrastrukturën e ofruesit të shërbimeve pagesore, i cili i mban llogaritë pagesore për futje të kredencialeve të sigurisë së përdoruesit.
- **“Inkorporimi i procedurës së autentifikimit”** (ang. embedded) është metodë në të cilën kredencialet e sigurisë së përdoruesit të shërbimit pagesor ia kanë dorëzuar ofruesit të shërbimeve pagesore për dhënie të informacioneve të llogarive pagesore dhe ofruesëve të shërbimeve të cilët inicojnë pagesa për vërtetim të identitetit të përdoruesit të shërbimit pagesor pa komunikuar me ofruesin e shërbimeve pagesore i cili i mban llogaritë pagesore.
- **“Mjedisi i sigurt”** i përfshin së paku hapësirat e ofruesit të shërbimeve pagesore, internet-mjedisin të cilin e siguron ofruesi i shërbimeve pagesore dhe internet-faqe të ngjajshme dhe bankomate që i përdor ofruesi i shërbimeve pagesore dhe që nuk janë në kompetencë të tij.
- **“Interfejsi”** është kanal i komunikimit nëpërmjet të cilit ofruesi i shërbimit pagesor që mban llogari pagesore mundëson procedura, protokole dhe pajisje të standardizuara për lidhje dhe komunikim të sigurt, si dhe shkëmbimin e të dhënave për nevojat e ofrimit të shërbimeve pagesore dhe ndjekjen e transaksioneve pagesore.

II. KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR ZBATIM TË AUTENTITETIT

3. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të obliguar të vendosin mekanizma për ndjekje të transaksioneve të cilat iu mundësojnë zbulimin e transaksioneve pagesore të pa autorizuar ose mashtruese, për nevojën e zbatimit të masave të sigurisë nga pika 1), paragrafi (1), nënparagrafi (1) i këtij vendimi.

Mekanizmat nga paragrafi (1) i kësaj pike bazohen në analizën e transaksioneve pagesore në të cilat mirren elemente karakteristike të përdoruesit të shërbimeve pagesore në korniza të përdorimit të zakonshëm të kredencialeve të sigurisë së përdoruesit.

4. Ofruesit e shërbimeve pagesore sigurojnë, me mekanizman e ndjekjes së transaksioneve nga pika 3) paragrafi (1) i këtij vendimi, që të paktën të përfshihet secili nga faktorët e rrezikut të listuar:
 - elemente të evidentuara, kompromituara ose të vjedhura për vërtetim të identitetit të përdoruesit të shërbimeve pagesore të cilat përdoren gjatë autentifikimit;
 - shuma e çdo transaksioni pagesor;



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

- sjellje e pazakonshme e përdoruesit të shërbimit pagesor ose ndryshim në qasjen e llogarisë pagesore, direkt, onlajn (për shembull: ndryshim në internet-adresat e zakonshme të qasjes ose ndryshimi i shpejtë i lokacionit gjatë një ose më shumë kanaleve të komunikimit, të ashtuquajtura udhëtime të pamundshme, ndryshim të pajisjes nga i cili kryhen pagesat, pagesa atipike të përdoruesit ndaj kategorive të caktuara të tregtarëve, të dhëna të pazakonta të transaksioneve pagesore);
- skenare të njohura të mashtrimit gjatë sigurimit të shërbimeve pagesore;
- prania e softuerit keqdashës në kanalën e komunikimit të vendosur nga distanca gjatë procedurës së autentifikimit.

III. MASA TË SIGURISË PËR ZBATIMIN E AUTENTIFIKIMIT TË PËRFORCUAR

Kodi i autentifikimit

5. Ofruesi i shërbimeve pagesore është i obliguar të aplikojë autentifikim të përforcuar të klientit, me që ky autentifikim duhet të bazohet në dy ose më shumë elemente nga këto kategori: dituri (diçka që vetëm klienti e din), posedim (diçka që vetëm klienti e posedon) dhe pronësi (diçka që klienti është) dhe duhet të krijojë kod të identifikimit.

Ofruesi i shërbimit pagesor e pranon kodin e autentifikimit vetëm njëherë për qasje deri te llogaria pagesore e disponueshme onlajn, inicim të transaksionit pagesor elektronik dhe kryerjen e aktiviteteve tjera, të cilat zhvillohen nëpërmjet mjeteve të komunikimi nga distanca, të cilat mund të sjellin te rreziku i mashtrimit gjatë pagesës ose mënyrave tjera të keqpërdorimit.

6. Për nevojat e pikës 5) të këtij vendimi, ofruesit e shërbimeve pagesore janë të obliguar të vendosin masa sigurie me të cilat sigurohet plotësimi i secilës të këtyre kërkesave:
- pamundësi për të gjetur informacion lidhur me ndonjë nga elementet e listuara në pikën 5), paragrafi (1) gjatë zbulimit të kodit për autentifikim;
 - pamundësi të gjenerohet kod i ri i autentifikimit, në bazë të njohurisë për tjetër kod të tillë të krijuar më herët;
 - pamundësi të falsifikohet kodi i autentifikimit.
7. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të obliguar të sigurojnë autentifikim nëpërmjet krijimit të kodit përkatës të autentifikimit, i cili i përfshin këto masa:
- në rast kur nuk është i suksesshëm gjenerimi i kodit të autentifikimit, nuk duhet të ekzistojë mundësia të zbulohet arsya se cili nga elementet e pikës 5) të këtij vendimi ka qenë i gabuar;
 - Numri i përpjekjeve të njëpasnjëshme të dështuara të autentifikimit, pas së cilës qasja çaktivizohet ose bllokohet përkohësisht ose përgjithmonë, nuk duhet të jetë më e madhe se pesë në një periudhë kohore të caktuar;
 - kanali i vendosur për komunikim nga distanca i mbrojtur nga zbulimi i të dhënave gjatë autentifikimit dhe nga përdorimi i tyre nga personat të pa autorizuar, në pajtim me kërkesat nga kapitulli V i këtij vendimi, dhe



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

- periudha maksimale jo aktive e pagesit pas autentifikimit nuk guxon të jetë më e gjatë se pesë minuta.
8. Nëse qasja është çaktivizuar ose bllokuar përkohësisht në pajtim me pikën 7), paragrafi (1), nënparagrafi (2), ofruesi i shërbimeve pagesore është i obliguar ta përcaktojë kohëzgjatjen dhe numrin e përsëritjeve sipas karakteristikave të shërbimit e cila i sigurohet pagesit, rreziqet e lidhura me atë shërbim, duke i marrë parasysh të paktën faktorët e rrezikut të theksuar në pikën 4) të këtij vendimi.
- Ofruesi i shërbimit pagesor është i obliguar ta informojë pagesin për bllokimin e instrumentit pagesor elektronik para se ajo të bëhet e përhershme, nëse nuk është e mundur, atëherë menjëherë pas bllokimit.
- Nëse bllokimi është i përhershëm, ofruesi i shërbimeve pagesore është i obliguar të vendosë procedurë të sigurisë me të cilën do të largohet bllokimi i instrumentit pagesor elektronik ose të zavendësohet instrumenti pagesor elektronik me të ri.

Lidhja dinamike

9. Në rast kur ofruesit e shërbimeve pagesore zbatojnë autentifikim të përforcuar të klientit, si shtesë e kërkesave nga pikat 5), 6), 7) dhe 8) të këtij vendimi, ato janë të detyruar të vendosin edhe masa sigurie të cilat i plotësojnë këto kërkesa:
- Paguesi është i njoftuar për shumën e transaksionit pagesor dhe për pranuesin e pagesës;
 - kodi i krijuar i autentifikimit i përcaktuar specifikisht për shumën e transaksionit pagesor dhe pranuesin e pagesës të cilën paguesi e ka caktuar gjatë inicimit të transaksionit;
 - kodi i autentifikimit i cili është pranuar nga ofruesi i shërbimit pagesor përputhet me shumën origjinale të deklaruar në transaksionin pagesor dhe në identitetin e pranuesit të pagesës së caktuar nga paguesi;
 - çdo ndryshim i shumës së transaksionit pagesor ose pranuesit të pagesës sjell deri tek anulimi i kodit të krijuar të autentifikimit.

Për qëllimet e paragrafit (1) të kësaj pike, ofruesit e shërbimeve pagesore vendosin masa të sigurisë me të cilat sigurohet besueshmëri, autentitet dhe integritet për secilën nga këto informacione:

- shuma e transaksionit pagesor dhe pranuesit të pagesës në të gjitha fazat e autentifikimit, dhe
- informacionet të cilat i janë shfaqur pagesit në të gjitha fazat e autentifikimit, përfshirë edhe krijimin, transmetimin dhe përdorimin e kodit të autentifikimit.

Për qëllimet e paragrafit (1), nënparagrafi (2) të këtij vendimi dhe nëse ofruesit e shërbimeve pagesore zbatojnë autentifikim të përforcuar ndaj klientëve zbatohen këto kërkesa për kodin e autentifikimit:

- te transaksionet pagesore të bazuara në kartela, për të cilat paguesi jep pëlqim për rezervim të shumës së caktuar të fondeve, kodi i autentifikuar i përcaktuar



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

specifikisht për shumën për të cilën paguesi ka dhënë pëlqim për rezervim gjatë incimit të transaksionit;

- te transaksionet pagesore për të cilat paguesi ka dhënë pëlqim të ekzekutohen si seri / grupe të transaksioneve pagesore elektronike të destinuara për një ose më shumë pranues të pagesave, kodi i autentifikimit është përcaktuar specifikisht me shumën totale të serisë së transaksioneve pagesore dhe pranuesëve të listuar të pagesave në serinë / grupin.

Kërkesat për elementet e karakterizuara si njohuri

10. Ofruesit e shërbimeve pagesore, janë të obliguar të vendosin masa për ulje të rrezikut nga zbulimi i elementeve nga kategoria njohuri nga ose të personave të pa autorizuar.

Përdorimi i elementeve të karakterizuara si njohuri nga ana e paguesit, i nënshtrohet ndryshimit të masave të uljes së rrezikut nga zbulimi i tyre nga personat e paautorizuar.

Kërkesat për elementet e karakterizuara si posedim

11. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të obliguar të vendosin masa për ulje të rrezikut nga përdorimi i elementeve nga kategoria posedim nga personat e pa autorizuar.

Përdorimi i elementeve të karakterizuara si posedim nga ana e paguesit nënshtrohen në zbatim të masave të cilat kanë për qëllim ta ndërprejnë riprodhimin e tyre.

Kërkesa për pajisjet dhe softuerin të cilët janë lidhur me elementet e karakterizuara si pronësi

12. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të obliguar të vendosin masa për ulje të rrezikut nga përdorimi i elementeve të kategorisë pronësi nga personat e paautorizuar dhe të cilët ngarkohen në pajisje dhe softuer për atë qëllim, të dorëzuara paguesit.

Përdorimi i elementeve të karakterizuara si pronësi nga ana e paguesit, i nënshtrohen zbatimit të masave të cilat janë të destinuara për parandalim të qasjes së pa autorizuar, si dhe garantimin e rezistencës së pajisjeve dhe softuerit në të cilat ngarkohen.

Pavarësia e elementeve

13. Ofruesit e shërbimeve pagesore të cilat zbatojnë autentifikim të përforcuar ndaj klientëve nëpërmjet përdorimit të elementeve në pajtim me pikat 10), 11) dhe 12) të këtij vendimi, janë të obliguar të vendosin masa me të cilat sigurohet zbulimi i sekretit nga një prej elementeve që mos t'i rrezikojë të tjerët.

Ofruesit e shërbimeve pagesore gjatë përdorimit të çdo elementi nga autentifikimi i forcuar ose gjatë krijimit të kodit të autentifikimit nëpërmjet përdorimit të pajisjes shumëfunktionale janë të obliguar të vendosin masa të sigurisë për ulje të rrezikut nga keqpërdorimi i pajisjes.

Për nevojat e paragrafit (2) të këtij vendimi, ofruesit e shërbimeve pagesore për ulje të rrezikut i zbatojnë këto masa:



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

- përdorim të mjediseve të sigurta për ekzekutim me ndihmën e softuerit të instaluar në pajisjen shumëfunktionale;
- mekanizma me të cilat mbrohet softueri ose pajisja nga ndryshimet nga ana e paguesit ose nga personi i tretë, dhe
- në rast të ndryshimit të vërtetuar të softuerit ose pajisjes, ekzistimit të mekanizmave për ulje të pasojave nga ajo.

IV. PËRJASHTIME NGA ZBATIMI I AUTENTIFIKIMIT TË PËRFORCUAR TË KLIENTIT

Informacione të llogarisë pagesore

14. Ofruesëve të shërbimeve pagesore iu është lejuar të zbatojnë përjashtim nga autentifikimi i forcuar i klientit, me kusht t'i respektojnë kërkesat e definuara me pikën 4) të këtij vendimi edhe kur përdoruesi i shërbimit pagesor ka qasje te llogaria pagesore nga distanca, direkt, onlajn, pa lëshimin e të dhënave të ndjeshme të pagesave, në rastet kur kërkohet informacion për:
- gjendjen e një ose më shumë llogarive pagesore të caktuara, ose
 - transaksionet pagesore të ekzekutuara në 90 ditët e fundit nëpërmjet llogarive pagesore të caktuara nga ana e përdoruesit.
15. Për qëllimet e zbatimit të pikës 14) të këtij vendimi, ofruesit e shërbimeve pagesore nuk mund të zbatojnë përjashtim nga autentifikimi i forcuar i klientit, nëse është plotësuar së paku një prej këtyre kushteve:
- përdoruesi i shërbimit pagesore për herë të parë akseson nga distanca, direkt, onlajn, deri te informacionet nga pika 14) të këtij vendimi;
 - kanë kaluar më shumë se 90 dita nga hera e fundit kur përdoruesi i shërbimit pagesor ka aksesuar nga distanca, direkt, onlajn tek informacionet e renditura në pikën 14), paragrafi (1), nënparagrafi (2) të këtij vendimi, me zbatim të autentifikimit të forcuar.

Pagesa pa kontakt në терминаlet e vendeit të shitjes

16. Ofruesëve të shërbimeve pagesore ju është lejuar të zbatojnë përjashtim nga autentifikimi i forcuar i klientit, me kusht që t'i respektojnë kërkesat e definuara me pikën 4) të këtij vendimi dhe nëse paguesi inicon transaksion pagesor elektronik pa kontakt nëpërmjet mjeteve të komunikimit nga distanca nën këto kushte:
- shuma e transaksionit pagesor elektronik pa kontakt nëpërmjet mjeteve të komunikimit nga distanca nuk tejkalon 3000 denarë;
 - shuma totale e transaksioneve pagesore të kaluara elektronike pa kontakt të inicuar me ndihmën e instrumentit pagesor i cili posedon funksion pa kontakt nga data e ndryshimit të fundit të autentitetit të forcuar të klientit nuk tejkalon 9000 denarë; ose
 - Numri i transaksioneve pagesore të njëpasnjëshme elektronike pa kontakt të inicuar me ndihmën e instrumentit pagesor i cili posedon funksion pa kontakt nga e ndryshimit të fundit të autentitetit të forcuar nuk është më i madh se pesë.



Terminale vetëshërbyese për pagesa të shërbimeve të transportit dhe tarifët e parkimit

17. Ofruesëve të shërbimeve pagesore ju është lejuar të zbatojnë përjashtim nga autentifikimi i forcuar i klientit me kusht që t'i respektojnë kërkesat e definuara me pikën 4) të këtij vendimi dhe nëse paguesi inicon transaksion pagesor elektronik pa kontakt nëpërmjet mjeteve të komunikimit nga distanca me terminal vetëshërbyes për nevojat e pagesës së shërbimeve të transportit dhe tarifës së parkimit.

Lista e pranuesëve të autorizuar të pagesës

18. Ofruesit e shërbimeve pagesore zbatojnë autentifikim të forcuar në rast kur paguesi harton ose ndryshon listën e pranuesëve të autorizuar të pagesës, nëpërmjet ofruesit të shërbimeve pagesore i cili e mban llogarinë pagesore.

Ofruesëve të shërbimeve pagesore ju është lejuar të zbatojnë përjashtim nga autentifikimi i forcuar i klientit, me kusht që t'i respektojnë kërkesat e definuara me pikën 4) të këtij vendimi, nëse paguesi inicon transaksion pagesor, ndërsa pranuesi i pagesës është pjesë e listës nga paragrafi (1) i kësaj pike.

Përsëritja e transaksioneve

19. Ofruesit e shërbimeve pagesore zbatojnë autentifikim të klientit, nëse paguesi harton, ndryshon ose për herë të parë inicon seri të transaksioneve pagesore elektronike të përsëritura me shumë dhe pranues të njejtë të pagesës.

Ofruesëve të shërbimeve pagesore ju është lejuar të zbatojnë përjashtim nga autentifikimi i forcuar i klientit, me kusht që t'i respektojnë kërkesat e definuara me pikën 4) të këtij vendimi, gjatë inicimit të çdo transaksioni të ardhshëm pagesor si pjesë të serisë së njëpasnjëshme të transaksioneve pagesore nga paragrafi (1) i kësaj pike.

Transfere kreditore mes llogarive të personit të njejtë fizik dhe juridik

20. Ofruesëve të shërbimeve pagesore ju lejohet të zbatojnë përjashtim nga autentifikimi i forcuar i klientit, me kusht që ti respektojnë kërkesat me pikën 4) të këtij vendimi, nëse paguesi inicon transfer kreditor dhe njëkohësisht paguesi dhe pranuesi janë personi i njejtë fizik dhe juridik dhe ato llogari mbahen nga ofruesi i njejtë i shërbimeve pagesore që mban llogari pagesore.

Transaksione me vlerë të vogël

21. Ofruesëve të shërbimeve pagesore ju është lejuar të zbatojnë përjashtim nga autentifikimi i forcuar i klientit, nëse gjatë inicimit të transaksionit pagesor elektronik nëpërmjet mjeteve të komunikimit nga distanca, për të cilën janë plotësuar këto kushte:

- shuma e transaksionit pagesor elektronik nëpërmjet mjeteve të komunikimit nga distanca nuk tejkalon 1200 denarë; dhe



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

- shuma totale e transaksioneve pagesore të kaluara elektronike nëpërmjet mjeteve të komunikimit nga distanca të cilat i ka inicuar paguesi nga ndryshimi i fundit të autentitetit të forcuar të klientit nuk tejkalon 6000 denarë, ose
- numri i transaksioneve pagesore të kaluara elektronike nëpërmjet mjeteve të komunikimit nga distanca, të cilat i ka inicuar paguesi nga ndryshimi i fundit të autentitetit të forcuar të klientit nuk tejkalon pesë transaksionet pagesore të njëpasnjëshme elektronike nëpërmjet mjeteve të komunikimit nga distanca.

Procedura korporative të sigurisë dhe protokole të pagesave

22. Ofruesëve të shërbimeve pagesore ju është lejuar të zbatojnë përjashtime nga autentifikimi i forcuar të klientëve persona juridik, të cilët inicojnë transaksione pagesore me ndihmën e procedurave të dedikuara dhe protokoleve të pagesës, që janë të disponueshme vetëm për paguesit të cilët nuk janë konsumatorë, nëse ato procedura ose protokolle garantojnë nivel ekuivalent të sigurisë në pajtim me ligjin.

Analiza e rrezikut nga transaksioni

23. Ofruesëve të shërbimeve pagesore nuk ju lejohet të zbatojnë përjashtim nga autentifikimi i klientit, nëse paguesi inicon transaksion pagesor elektronik nëpërmjet mjeteve të komunikimit nga distanca, për të cilën ofruesi i shërbimeve pagesore i ka përcaktuar se janë me rrezik të ulët, në pajtim me mekanizmat e ndjekjes së transaksioneve të parapara me pikën 4), paragrafi (1), nënparagrafi (4) të këtij vendimi.

Transaksioni pagesor nga paragrafi (1) i kësaj pike është me rrezik të ulët, nëse janë plotësuar këto kushte:

- norma e mashtimit për atë lloj të transaksionit, të llogaritur në pajtim me pikën 24) dhe njoftimet nga ofruesi i shërbimeve pagesore, është e njëjtë ose më e ulët se norma referuese e mashtimit, të theksuara në tabelën e Aneksit nr. 1, i cili është në shtojcë të këtij vendimi për artikujt "transaksione pagesore elektronike me instrument pagesor të bazuar në kartelë" dhe "transfera kreditore elektronike" përkatësisht;
- Shuma e transaksionit nuk e tejkalon shumën e pragut përkatës për përjashtim të theksuar në tabelën e Aneksit nr. 1, në shtojcë të këtij vendimi;
- ofruesit e shërbimeve pagesore pas analizës së kryer të rrezikut në kohë reale nuk kanë përcaktuar asnjë nga këto dukuritë: pagesë ose sjellje e pazakontë e paguesit; informacione për përdorimin e pazakontë të pajisjes / softuerit për qasje të paguesit; pjesëmarrje të softuerit keqdashës në çdo kanal të vendosur nga distanca për komunikim në procesin e autentifikimit; skenare të njohura të mashtimit gjatë ofrimit të shërbimeve pagesore, lokacion i pazakontë i paguesit; dhe vend me rrezik të lartë i pranuesit.

Ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët kanë për qëllim të zbatojnë përjashtim nga autentifikimi i forcuar të klientëve të transaksionit pagesor elektronik nëpërmjet mjeteve të komunikimit nga distanca, në bazë të paragrafit (2) të këtij vendimi, janë të detyruar t'i marrin parasysh këto faktorë të rrezikut:



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

- skemat e mëparshme të shpenzimit të përdoruesëve individual të shërbimeve pagesore;
- historia e transaksioneve pagesore të secilit nga përdoruesit të shërbimeve pagesore të cilat i ofron ofruesi i shërbimeve pagesore;
- Lokacioni i paguesit dhe vendi i pranuesit për kohëzgjatjen e transaksionit pagesor nëpërmjet mjeteve të komunikimit nga distanca në rast kur pajisjet ose softueri për qasje janë të mundësuar nga ana e ofruesit të shërbimit pagesor;
- Përcaktimin e skemave të pazakonta të pagesave nga ana e përdoruesit të shërbimeve pagesore duke pasur parasysh historinë e tij të pagesave.

Ofruesi i shërbimeve pagesore është i detyruar t'i kombinojë të gjitha faktorët e rrezikut gjatë llogaritjes së vlerësimit total të rrezikut të çdo transaksion, që ta përcaktojë se a duhet për atë pagesë të zbatojë autentifikim të forcuar.

Llogaritje të normës së mashtrimit

24. Ofruesi i shërbimit pagesor për çdo lloj të transaksionit të theksuar në tabelën e Aneksit nr. 1, në shtojcë të këtij vendimi, siguron normat totale të mashtrimit të cilat lidhen edhe me transaksionet pagesore të cilat janë vërtetuar me zbatimin e autentifikimit të forcuar të klientit dhe të atyre të cilat ekzekutohen në pajtim me zbatimin e përjashtimeve të theksuara në pikat 18), 19), 20), 21), 22) dhe 23) nga ky vendim, të jenë të barabarta ose më të ulëta se norma referuese e mashtrimit për llojin e njëjtë të transaksionit pagesor të theksuar në tabelën në Aneksin nr. 1, në shtojcë të këtij vendimi.

Norma totale e mashtrimit për çdo lloj të transaksionit të theksuar në tabelën e Aneksit nr. 1, në shtojcë të këtij vendimi, llogaritet baza tremujore, si vlerë totale e të gjitha transaksioneve të pa autorizuar ose mashtruese nëpërmjet mjeteve të komunikimit nga distanca, pavarësisht se a ka kthim të fondeve, të ndarë me vlerën totale të të gjitha transaksioneve pagesore elektronike nëpërmjet mjeteve të komunikimit në distancë për llojin e njëjtë të transaksioneve, pa dallim se a është zbatuar autentifikimi i forcuar i klientëve ose janë ekzekutuar me zbatim të përjashtimeve të theksuara në pikat 18), 19), 20), 21), 22) dhe 23) të këtij vendimi.

Llogaritja e normave të mashtrimit nga paragrafi (2) i kësaj pike është temë e shqyrtimit revizor të paraparë me pikën 27) të këtij vendimi me të cilin sigurohet plotësia dhe saktësia e tyre.

Metodologjia dhe modeli i llogaritjes së normave të mashtrimit të cilat përdoren nga ana e ofruesit të shërbimeve pagesore, si dhe normat e mashtrimit përkatësisht dokumentohen dhe janë të disponueshme me kërkesë të Bankës Popullore.

Ndalesë së zbatimit të përjashtimeve nga analiza e rrezikut të transaksioneve

25. Ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët i zbatojnë përjashtimet nga pika 23 të këtij vendimi menjëherë e njoftojnë Bankën Popullore, nëse një nga normat e ndjekjes së mashtrimeve për cilin do lloj të transaksioneve pagesore të theksuara në tabelën e Aneksit nr. 1, në shtojcë të këtij vendimi, e tejkalon normën e vlefshme referuese të mashtrimit dhe njëkohësisht



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

dorëzojnë përshkrim të masave që do ti marrin që përsëri të sigurojnë përshtatje të normës së mashtrimit të cilën e ndjekin me normat e vlefshme referuese të mashtrimit.

Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të obliguar ta ndërprejnë menjëherë zbatimin e përjashtimeve të theksuara në pikën 23) të këtij vendimi, për të gjitha llojet e transaksioneve pagesore të theksuara në tabelën e Aneksit nr. 1, në shtojcë të këtij vendimi, në prapun e caktuar të përjashtimit, nëse norma e mashtrimit të cilën e ndjekin për kohëzgjatje të dy tremujorëve të njëpasnjëshme, e tejkalon normën referuese të mashtrimit e cila zbatohet për atë lloj të transaksionit pagesor në prapun e përjashtimit.

Pas ndërprerjes me zbatimin e përjashtimeve të pikës 23) të këtij vendimi dhe në pajtim me paragrafin (2) të kësaj pike, ofruesit e shërbimeve pagesore nuk duhet përsëri ta përdorin atë përjashtim, derisa norma e tyre e llogaritur e mashtrimit nuk është e barabartë ose nën normat referuese të mashtrimit për atë lloj të transaksionit pagesor të theksuar në tabelën e Aneksit nr. 1, në shtojcë të këtij vendimi, në atë prap të përjashtimit gjatë një tremujori.

Nëse ofruesit e shërbimeve pagesore kanë për qëllim që përsëri ta zbatojnë përjashtimin e theksuar në pikën 23) të këtij vendimi, para se të fillojnë ta zbatojnë në një afat të arsyeshëm, e njoftojnë Bankën Popullore me dëshmi për ripërputhjen e normës së tyre të mashtrimit, me normën referuese të mashtrimit të zbatueshme për atë prap të përjashtimit, në pajtim me paragrafin (3) të këtij vendimi.

Ndjekja

26. Që të mund të zbatohen përjashtimet nga pikat 14), 15), 16), 17), 18), 19), 20), 21), 22) dhe 23) të këtij vendimi, ofruesit e shërbimeve pagesore i evidentojnë dhe i ndjekin këto të dhëna për çdo lloj të institucioneve pagesore, me ndarje të transaksioneve pagesore të cilat ekzekutohen nëpërmjet mjeteve të komunikimit nga distanca dhe atyre të cilat nuk ekzekutohen nëpërmjet mjeteve të komunikimit në bazë tremujore:

- vlera totale e transaksioneve pagesore të pa autorizuar dhe mashtruese, vlera totale e të gjitha transaksioneve pagesore dhe normave të llogaritura të mashtrimit, përfshirë edhe shpërndarja e transaksioneve pagesore të inicuar me zbatim të autentifikimit të forcuar dhe në korniza të çdo përjashtimi;
- vlera mesatare e transaksioneve pagesore, përfshirë edhe shpërndarjen e transaksioneve pagesore të inicuar me zbatimin e autentifikimit të klientit dhe në korniza të çdo përjashtimi;
- numri i transaksioneve pagesore të cilat kanë zbatuar përjashtime dhe përqindja e tyre ndaj totalit të transaksioneve pagesore.

Ofruesit e shërbimeve pagesore i dorëzojnë rezultatet e ndjekjes në pajtim me paragrafin (1) të kësaj pike, me kërkesë të Bankës Popullore.

Revizimi

27. Ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët zbatojnë përjashtim nga autentifikimi i forcuar, në pajtim me pikën 23) të këtij vendimi, janë të obliguar të zbatojnë revizim të metodologjisë, modelit dhe të normave të paraqitura të mashtrimit.



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të obliguar të ekzekutojnë revizim nga paragrafi (1) i kësaj pike, vitin e parë pas zbatimit të përjashtimeve nga pika 23) e këtij vendimi dhe së paku në çdo tre vjet të ardhshme ose më shpesh, ose me kërkesë të Bankës Popullore.

V. BESUESHMËRI DHE INTEGRITET I TIPAREVE TË SIGURISË SË PËRDORUESËVE

Kërkesa të përgjithshme

28. Ofruesit e shërbimeve pagesore sigurojnë besueshmëri dhe integritet të tipareve të sigurisë së përdoruesëve të shërbimeve pagesore, përfshirë edhe kodet e autentifikimit, gjatë kohës së fazave të autentifikimit.

Për nevojat e paragrafit (1) të kësaj pike, ofruesit e shërbimeve pagesore për ulje të rrezikut i zbatojnë këto kërkesa:

- tiparet e sigurisë së përdoruesëve janë të mbuluar dhe nuk janë plotësisht të lexueshme, gjatë futjes nga ana e përdoruesit të shërbimeve pagesore për qëllimet e autentifikimit;
- tiparet e sigurisë së përdoruesëve në format më të detajuar dhe materialeve kriptografike të cilat lidhen me shifrimin e tyre nuk regjistrohen në format të lexueshëm;
- materiali sekret kriptografik është i mbrojtur me zbulim të paautorizuar.

Ofruesit e shërbimeve pagesore e dokumentojnë procedurën e udhëheqjes me materialin kriptografik, me të cilin tiparet e sigurisë së përdoruesëve shifrohen edhe në mënyrë tjetër bëhen të palexueshme.

Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të obliguar të sigurojnë përpunim dhe ridrejtim të tipareve të sigurisë së përdoruesëve dhe kodeve të autentifikimit të cilat janë krijuar në pajtim me kreun III të këtij vendimi, të zhvillohen në mjedis të sigurt dhe në pajtim me standardet përkatëse industriale të pranuar gjërësisht të miratuara nga trupat ndërkombëtare dhe europiane të standardizimit.

HARTIMI DHE DORËZIMI I TIPAREVE TË SIGURISË SË PËRDORUESËVE

29. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të obliguar të sigurojnë hartimin e tipareve të sigurisë së përdoruesëve në mjedis të sigurt.

Ofruesit e shërbimeve pagesore i ulin rreziqet nga përdorimi i paautorizuar i tipareve të sigurisë së përdoruesëve, pajisjeve dhe softuerit të autentifikimit pas humbjes së tyre, vjedhjes ose kopjimit të tyre para se të dorëzohen te paguesi.



Lidhja me ofruesin e shërbimit pagesor

30. Ofruesit e shërbimeve pagesore sigurojnë që vetëm përdoruesi i shërbimit pagesor është i lidhur, në mënyrë të sigurtë, me tiparet e sigurisë së përdoruesit të dhëna të pajisjeve dhe softuerit të autentifikimit.

Për qëllimet e paragrafit (1) të kësaj pike, ofruesit e shërbimeve pagesore i plotësojnë këto kërkesa:

- lidhja e identitetit të përdoruesit të shërbimeve pagesore me tiparet e sigurisë së përdoruesit të shërbimeve pagesore me tiparet e sigurisë së përdoruesit, pajisjeve dhe softuerit të autentifikimit kryhet në një mjedis të sigurt për të cilin përgjegjës është ofruesi i shërbimeve pagesore;
- lidhja e identitetit të përdoruesit të shërbimeve pagesore me tiparet e sigurisë së përdoruesit të shërbimeve pagesore me tiparet e sigurisë së përdoruesit, pajisjeve dhe softuerit të autentifikimit, nëpërmjet mjeteve të komunikimit nga distanca kryhet me zbatimin e autentifikimit të forcuar.

Dorëzimi i tipareve të sigurisë së përdoruesit, pajisjeve dhe softuerit të autentifikimit

31. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të obliguar të sigurojnë dorëzimin e tipareve të sigurisë së përdoruesit, pajisjeve dhe softuerit të autentifikimit të përdoruesëve të shërbimeve pagesore të zhvillohet në mënyrë të sigurtë, duke pasur parasysh rreziqet e lidhura nga përdorimi i paautorizuar në rast të humbjes, vjedhjes ose kopjimit të tyre.

Për qëllimet e paragrafit (1) të kësaj pike, ofruesit e shërbimeve pagesore i zbatojnë këto kërkesa:

- Procedura efikase dhe të sigurtë për dorëzim me të cilat sigurohen tiparet e sigurisë së përdoruesit, pajisjeve dhe softuerit të autentifikimit të dorëzohen te përdoruesi legjitim i shërbimeve pagesore;
- mekanizmat të cilat ofruesit të shërbimeve pagesore i mundësojnë kontrollimin e autenticitetit të softuerit të autentifikimit, të cilat përdoruesit të shërbimeve pagesore i është dërguar nëpërmjet rrjetit të komunikimit të disponueshëm publikisht, siç është interneti;
- procedurat e dërgesës në rast kur tiparet e sigurisë së përdoruesit dërgohen jashtë hapësirave të ofruesit të shërbimeve pagesore ose nëpërmjet mjeteve të komunikimit nga distanca, me të cilat sigurohet: person i pa autorizuar nuk mund të merr më shumë se një tipar të sigurisë dhe pajisje ose softuer të autentifikimit kur dorëzohen nëpërmjet kanalit të njejtë; tiparet e sigurisë së përdoruesit, pajisjet dhe softueri i autentifikimit detyrimisht kërkojnë aktivizimin e tyre para se të përdoren;
- procedurat e aktivizimit të detyrueshëm të tipareve të sigurisë së përdoruesit dhe pajisjeve ose softuerit të autentifikimit, para përdorimit të tyre të parë, mundësojnë aktivizim në mjedis të sigurtë, në pajtim me procedurat e lidhjes nga pika 30) e këtij vendimi.



RINOVIMI I TIPAREVE TË SIGURISË SË PËRDORUESËVE

32. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të obliguar të sigurojnë rinovimin ose riaktivizimin e tipareve të sigurisë së përdoruesit të jetë në pajtim me procedurat e lëshimit, lidhjes dhe dorëzimit të tipareve të sigurisë së përdoruesit dhe pajisjeve të autentifikimit të definuara me pikat 29), 30) dhe 31) të këtij vendimi.

Shkatërrimi, deaktivizimi dhe revokimi

33. Ofruesit e shërbimeve pagesore sigurojnë procese efikase të zbatimit të masave të sigurisë në vijim:

- shkatërrim, deaktivizim dhe revokim të sigurtë të tipareve të sigurisë së përdoruesit, pajisjeve dhe softuerit të autentifikimit;
- nëse ofruesi i shërbimeve pagesore dorëzon pajisje ose softuer të autentifikimit për përdorim të shumëfishtë, para ripërdorimit nga përdoruesi tjetër i shërbimeve pagesore vendoset, dokumentohet dhe zbatohet ripërdorimi i sigurtë i pajisjes ose softuerit;
- deaktivizim ose revokim të informacioneve të lidhura me tiparet e sigurisë së përdoruesëve, të cilat mbahen në sistemet dhe bazat e të dhënave të ofruesëve të shërbimeve pagesore dhe varësisht nga rastet edhe në regjistra tjerë publik.

VI. Standarde të përgjithshme, të sigurt dhe të hapura të komunikimit

Kërkesa të përgjithshme të identifikimit gjatë komunikimit

34. Ofruesit e shërbimeve pagesore janë të obliguar të sigurojnë identifikim të sigurtë gjatë komunikimit mes pajisjes së paguesit dhe pajisjes së pranuesit i cili pranon transaksione pagesore elektronike dhe mes tjerash duke i përfshirë edhe терминаlet e pagesave.

Ofruesit e shërbimeve pagesore sigurojnë ulje efikase të rrezikut nga drejtimi i gabuar i komunikimit drejt personave të paautorizuar gjatë përdorimit të aplikacioneve të celularit dhe interfejsave tjera të cilat përdoruesit të shërbimeve pagesore i ofrojnë shërbime pagesore.

Kërkesa të përgjithshme për ndjekje të transaksioneve pagesore gjatë komunikimit

35. Ofruesit e shërbimeve pagesore vendosin procedura me të cilat do të sigurohet ndjekje e të gjitha transaksioneve pagesore dhe interaksioneve tjera mes përdoruesit të shërbimeve pagesore, ofruesëve tjerë të shërbimeve pagesore dhe subjekteve, përfshirë edhe tregtarët, gjatë sigurimit të shërbimeve pagesore dhe siguron informacione për të gjitha ngjarjet e rëndësishme të transaksioneve pagesore elektronike në të gjitha fazat e ekzekutimit të tyre dhe disponueshmërinë e tyre pas ekzekutimit të transaksioneve.

Për qëllimet e paragrafit (1) të kësaj pike, ofruesit e shërbimeve pagesore janë të obliguar të sigurojnë se çdo kanal i komunikimit i cili është vendosur drejt përdoruesit të shërbimeve pagesore, ofruesëve tjerë të shërbimeve pagesore dhe subjekteve, përfshirë edhe tregtarët, i përmban këto norma:



- shenjë e vetme identifikuese të kanalit të komunikimit;
- evidencë të detajuar të transaksionit, përfshirë edhe numrin e transaksionit, vulës elektronike kohore dhe të dhënat tjera relevante të transaksionit.

Kërkesa të veçanta për standardet e përgjithshme, të sigurta dhe të hapura të komunikimit

Interfejsë për qasje

36. Ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët i mbajnë llogaritë pagesore dhe të cilët paguesit i ofrojnë qasje te llogaria pagesore, direkt, onlajn, vendosin së paku një interfejs i cili i plotëson këto kërkesa:

- ofruesit e shërbimeve për dhënie të informacione të llogarive pagesore, ofruesit e shërbimeve për inicim të pagesave dhe ofruesëve të shërbimeve pagesore të cilët lëshojnë instrumente pagesore të bazuara mbi kartela, identifikohen mbi ofruesin e shërbimeve pagesore të cilët e mbajnë llogarinë pagesore;
- ofruesit e shërbimeve për dhënie të informacione për llogaritë pagesore komunikojnë në mënyrë të sigurtë kur kërkojnë dhe pranojnë informacione për një ose më shumë llogari pagesore të caktuara dhe transaksionet pagesore të lidhura me ato;
- ofruesit e shërbimeve për inicim të pagesave komunikojnë në mënyrë të sigurtë gjatë inicimit të urdhërpagesës nga llogaria pagesore e paguesit, pranim të informacionit kthyes gjatë inicimit të transaksionit pagesor dhe të gjitha informacioneve për zbatim të transaksionit pagesor, të cilat janë të disponueshme tek ofruesit e shërbimeve pagesore të cilat e mbajnë llogarinë pagesore.

37. Për nevojat e autentifikimit të përdoruesëve të shërbimeve pagesore, interfejsi i definuar në pikën 36) të këtij vendimi, të ofruesëve të shërbimeve për dhënie të informacione të llogarive pagesore dhe ofruesëve të shërbimeve për inicim të pagesave, ju mundëson të mbështeten në procedurat e autentifikimit të cilat ofruesi i shërbimeve pagesore, i cili e mban llogarinë pagesore ja jep përdoruesit të shërbimeve pagesore.

Interfejsi për qasje i plotëson së paku këto kërkesa:

- në bazë të pëlqimit të dhënë nga përdoruesi i shërbimit pagesor, ofruesi i shërbimeve të inicimit të pagesave ose ofruesit të shërbimeve për dhënie të informacioneve të llogarive pagesore, i urdhëron ofruesit të shërbimeve pagesore i cili e mban llogarinë pagesore të fillojë me procedurën e autentifikimit;
- kanalet e komunikimit mes ofruesit të shërbimeve pagesore të cilët e mbajnë llogarinë pagesore, ofruesit të shërbimeve për dhënie të informacioneve të llogarive pagesore, ofruesit të shërbimeve për inicim të pagesave dhe cili do përdorues tjetër të shërbimeve pagesore vendosen dhe mbahen gjatë kohës së procedurës së autentifikimit;
- siguron integritet dhe besueshmëri të tipareve të sigurisë së përdoruesit dhe kodeve të autentifikimit të transmetuara nga ose nëpërmjet ofruesit të shërbimeve pagesore për inicim të pagesave ose ofruesit të shërbimeve për dhënie të informacioneve të llogarive pagesore.



38. Ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët i mbajnë llogaritë pagesore janë të obliguar t'i përshtatin interfejsat e tyre me standardet e strukturës së të dhënave dhe modeleve të tyre, protokolet e nivelit aplikativ, transportues dhe autorizues, me zbatimin e standardeve industriale të pranuara gjërësisht të miratuara nga trupat e standardizimit ndërkombëtar dhe europian.

Ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët i mbajnë llogaritë pagesore sigurojnë dokumentacion teknik për interfejsat e tyre, duke theksuar totalin e procedurave, protokoleve dhe pajisjeve të cilat janë të nevojshme ofruesëve të shërbimeve për inicim të pagesave, ofruesëve të shërbimeve të dhënies së informacioneve të llogarive pagesore dhe ofruesëve të shërbimeve pagesore për lëshim të instrumenteve pagesore të bazara mbi kartela, të vendosë ndërveprim ndërmjet sistemeve të veta me sistemet e ofruesëve të shërbimeve pagesore të cilët i mbajnë llogaritë pagesore.

Ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët i mbajnë llogaritë pagesore me kërkesë të ofruesëve të shërbimeve për inicim të pagesave, ofruesëve të shërbimeve për dhënie të informacioneve të llogarive pagesore, ofruesëve të shërbimeve pagesore për lëshim të instrumenteve pagesore të bazuara mbi kartela, të cilat janë shënuar në regjistrin e institucioneve pagesore ose ofruesit të shërbimeve pagesore, i cili ka parashtruar kërkesë për marrje të lejes së ofrimit të shërbimeve pagesore, pa tarifë ta vendosin në disponim nga paragrafi (2) i kësaj pike dhe në faqen e tij të internetit të publikojnë përmbledhje nga dokumentacioni, së paku pesë muaj nga data e zbatimit të theksuar në pikën 67) nga ky vendim ose para datës së paraparë të fillimit të përdorimit të interfejsit, nëse data e fillimit të përdorimit të interfejsit është pas datës së theksuar në pikën e njëjtë.

39. Ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët i mbajnë llogaritë pagesore i sigurojnë të gjitha ndryshimet e dokumentacionit teknik për interfejsat e tyre të jenë të disponueshme tek ofruesit e shërbimeve për inicim të pagesave, ofruesëve të shërbimeve për ofrim të informacioneve të llogarive pagesore, ofruesëve të shërbimeve pagesore të cilët ofrojnë instrumente pagesore të bazuara në kartela, të cilat janë të shënuara në regjistrin e institucioneve pagesore ose ofruesit të shërbimeve pagesore i cili ka parashtruar kërkesë për marrjen e lejës së ofrimit të shërbimeve pagesore, përveç në kushte të jashtzakonshme.

Ndryshimi i dokumentacionit publik i interfejsit do të jetë e disponueshme sa më parë që mundet dhe së paku tre muaj para se të zbatohet ndryshimi.

Në rast të ndryshimeve të interfejsit, të imponuara nga kushtet e jashtzakonshme, ofruesit e shërbimeve pagesore janë të obliguar t'i dokumentojnë procedurat dhe me kërkesë t'i dorëzojnë te Banka Popullore.

40. Ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët i mbajnë llogaritë pagesore janë të obliguar të sigurojnë platformë dhe mbështetjetë teknike, për testimin e lidhjes dhe funksionaliteteve të softuereve dhe aplikacioneve për ofruesit e shërbimeve për inicim të pagesave, ofruesëve të shërbimeve për dhënie të informacioneve të llogarive pagesore, ofruesëve të shërbimeve pagesore të cilët ofrojnë instrumente pagesore të bazuara në kartela të cilat janë të shënuara në regjistrin e institucioneve pagesore ose ofruesit të shërbimeve pagesore, i cili ka parashtruar kërkesë për marrjen e lejës së ofrimit të shërbimeve pagesore.



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Platforma teknike e testimit duhet të jetë e disponueshme së paku pesë muaj para datës së zbatimit të theksuar në pikën 67) të këtij vendimi ose para datës së paraparë të fillimit të përdorimit të interfejsit, nëse data e fillimit të përdorimit të interfejsit është pas datës së theksuar në pikën e njëjtë.

Në platformën teknike të testimit nuk lejohet të shpërndahen të dhëna e pagesave.

Përdorimi i interfejsit

41. Ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët i mbajnë llogaritë pagesore vendosin interfejs, në pajtim me kërkesat nga pikat 36), 37), 38), 39) dhe 40) të këtij vendimi, nëpërmjet:
- sigurimit të interfejsit të dedikuar ose
 - Përdorimin e interfejsit të ofruesëve të shërbimeve pagesore nga pika 36) e këtij vendimi, e cila zbatohet për autentifikim dhe komunikim me përdoruesit e shërbimeve pagesore të cilin ai e siguron.

Kërkesë për interfejsin e dedikuar

42. Me kusht që të plotësohen kërkesat nga pikat 36), 37), 38), 39), 40) dhe 41) të këtij vendimi, ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët i mbajnë llogaritë pagesore të cilat kanë vendosur interfejs janë të obliguar të sigurojnë nivel të njëjtë të disponueshmërisë, efikasitetit, përfshirë edhe mbështetje, si dhe për interfejsin i cili përdoret për qasje të përdoruesëve të shërbimeve pagesore deri te llogaria pagesore, direkt, onlajn.

43. Ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët i mbajnë llogaritë pagesore, të cilët kanë vendosur interfejs të dedikuar, definojnë tregues kryesor transparent të efikasitetit dhe nivelin e synuar të shërbimeve, të cilët edhe në kahje të disponueshmërisë dhe të dhënave të shkëmbyera në pajtim me pikat 62), 63), 64), 65) dhe 66) të këtij vendimi, janë po aq strikte, sikur ato të interfejsit të cilin e përdorin përdoruesit e shërbimeve të tyre pagesore.

Gjatë ndjekjes së nivelit të shërbimeve, disponueshmërisë dhe efikasitetit, ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët i mbajnë llogaritë pagesore i ndjekin kahjet e dhëna në Aneksin nr. 2, shtojcë të këtij vendimi.

44. Ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët i mbajnë llogaritë pagesore dhe kanë vendosur interfejs kohor janë të obliguar të sigurojnë, që ai të mos krijojë pengesa në sigurimin e shërbimeve të inicimit të pagesave dhe shërbimeve për dhënie të informacioneve të llogarisë pagesore.

Si pengesa nga paragrafi (1) i kësaj pike, trajtohen këto raste:

- kur ofruesit e shërbimeve pagesore nga pika 36) e këtij vendimi nuk kanë mundësi t'i përdorin tiparet e sigurisë së përdoruesit, të cilat ofruesit e shërbimeve pagesore të cilat i mbajnë llogaritë pagesore ja kanë dorëzuar përdoruesëve të tyre;
- kërkesë për riautentifikim;



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

- kërkesë për kontrollim shtesë të lejeve të shënuara në regjistrin e institucioneve pagesore;
- kërkesë për kontrollim shtesë të pëlqimit të dhënë të cilën përdoruesit e shërbimeve pagesore ja kanë dhënë ofruesëve të shërbimeve për inicim të pagesave dhe ofruesëve të shërbimeve për dhënien e informacioneve të llogarive pagesore.

Ofruesi i shërbimeve pagesore i cili i mban llogaritë pagesore është i obliguar me kërkesë të Bankës Popullore të dorëzojë raport se interfejsi i dedikuar nuk shkakton pengesë gjatë sigurimit të shërbimeve të inicimit të pagesave dhe shërbimeve për dhënien e informacioneve të llogarive pagesore, në pajtim me kahjet e Aneksit nr. 5, në shtojcë të këtij vendimi.

45. Për nevojat e pikave 42) dhe 43) të këtij vendimi, ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët i mbajnë llogaritë pagesore e ndjekin disponueshmërinë dhe efikasitetin e interfejsit kohor.

Ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët i mbajnë llogaritë pagesore i publikojnë në internet-faqen e tyre statistikave tremujore për disponueshmërinë dhe efikasitetin e interfejsit të dedikuar dhe të interfejsit të cilin e përdorin përdoruesit e shërbimeve pagesore.

Gjatë publikimit të të dhënave statistikore për disponueshmërinë dhe efikasitetin e interfejsit të dedikuar të cilin e përdorin përdoruesit e vet, ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët i mbajnë llogaritë pagesore i ndjekin kahjet e dhëna në Aneksin nr. 3, në shtojcë të këtij vendimi.

46. Ofruesi i shërbimeve pagesore i cili i mban llogaritë pagesore është i detyruar të zbatojë stres testim të rezistencës së interfejsit të dedikuar, sipas kahjeve të dhënave të Aneksit nr. 4, në shtojcë të këtij vendimi.

Në kuadër të stres testimit të rezistencës së ofruesëve të shërbimeve pagesore të cilat i mbajnë llogaritë pagesore janë të obliguar ta përcaktojnë ndikimin që e kanë mbi disponueshmërinë dhe efikasitetin e interfejsit të dedikuar dhe nivelin e definuar të shërbimit.

Ofruesi i shërbimeve pagesore i cili i mban llogaritë pagesore është i obliguar, me kërkesë të Bankës Popullore, të dorëzojë raport përmbljedhës nga rezultatet e stres testit të fundit të realizuar të rezistencës, si dhe informacion për mënyrat me të cilat janë tejkaluar dobësitë e përcaktuara.

Strandardet e vazhdueshmërisë së interfejsit të dedikuar dhe kushteve të zbatimit më të lehtë

47. Ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët i mbajnë llogaritë pagesore gjatë dizajnit të interfejsit të dedikuar përfshijnë standarde të vazhdueshmërisë, nëpërmjet zhvillimit të strategjisë, planeve të vazhdueshmërisë, në rast kur interfejsi i dedikuar nuk funksionon në pajtim me kërkesat e pikave 42), 43), 44), 45) dhe 46) të këtij vendimi, pra kur është i padisponueshëm pa planifikuar ose në rast të ndërprerjes së sistemeve të tij.

Interfejsi është i padisponueshëm pa planifikuar ose ka ndodhur ndërprerje e sistemeve të tij, nëse nuk përgjigjet në afat prej 30 sekondave të pesë kërkesave të njëpasnjëshme për qasje të informacioneve të shërbimeve të inicimit të pagesave ose dhënies së informacioneve të llogarive pagesore.



48. Në planin e vazhdueshmërisë të punës është përshkruar mënyra e informimit të ofruesëve të shërbimeve pagesore të cilët e përdorin interfejsin e dedikuar, për masat e rivendosjes së sistemeve dhe përshkrimin e mundësive të disponueshme menjëherë, të cilat janë në disponim për ofruesit e shërbimeve pagesore.
49. Ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët i mbajnë llogaritë pagesore dhe ofruesëve të shërbimeve pagesore nga pika 36) e këtij vendimi, janë të obliguar pa anulim t'i paraqesin problemet të cilat paraqiten gjatë interfejsit të dedikuar, të theksuara në pikën 47) të këtij vendimi dhe informacioneve të lidhura me tejkalimin e problemeve të paraqitura në pajtim me kahjet e Aneksit nr. 8 shtojcë nga ky vendim të Banka Popullore.
50. Si pjesë e standardeve të vazhdueshmërisë, për funksionim në kushte të jashtzakonshme, ofruesit e shërbimeve pagesore nga pika 36 e këtij vendimi, mund t'i përdorin interfejsat të cilat përdoruesëve të shërbimeve pagesore ju kanë vënë në dispozicion për autentifikim dhe komunikim me ofruesin e shërbimeve pagesore i cili i mban llogaritë pagesore, derisa nuk sigurohet niveli i nevojshëm i disponueshmërisë dhe efikasitetit të interfejsit të dedikuar në pajtim me pikat prej 42) të pika 46) të këtij vendimi.
51. Për nevojat e pikës 50) të këtij vendimi, ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët i mbajnë llogaritë pagesore ju sigurojnë ofruesëve të shërbimeve pagesore nga pika 36) e këtij vendimi, të identifikohen me procedurat e autentifikimit të cilat ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët i mbajnë llogaritë pagesore i sigurojnë përdoruesit të shërbimeve pagesore.
- Nëse ofruesit e shërbimeve pagesore nga pika 36) e këtij vendimi e përdorin interfejsin nga pika 50) e këtij vendimi janë të obliguar:
- të marrin masa të nevojshme me të cilat sigurohet se ata nuk do të kenë qasje, nuk do të mund të ruajnë ose përpunojnë të dhëna për qëllime tjera, përveç për të siguruar shërbimin i cili është kërkuar nga përdoruesi i shërbimeve pagesore;
 - të vazhdojnë t'i plotësojnë detyrimet ligjore lidhur me rregullat e qasjes të llogaria pagesore, në rast të inicimit të pagesës dhe gjatë marrjes së informacione të llogarisë pagesore;
 - të evidentojnë të dhëna të cilat arrihet nëpërmjet interfejsit të cilin ofruesi i shërbimit pagesor, i cili i mban llogaritë pagesore e mban për nevojat e përdoruesëve të shërbimeve të veta pagesore dhe në kërkesë dhe pa anulim, t'i dorëzojnë shënimet nga të dhënat e evidentuara të Banka Popullore;
 - Me kërkesë të Bankës Popullore dhe pa anulim të paarsyeshëm, ta shpjegojnë mënyrën e përdorimit të interfejsit të cilin përdoruesit e shërbimeve pagesore ju është dhënë për përdorim gjatë qasjes të llogaria e tyre pagesore, direkt, onlajn;
 - në mënyrë përkatëse t'i informojnë ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët i mbajnë llogaritë pagesore.
52. Nëse ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët i mbajnë llogaritë pagesore kanë vendosur të përdorin interfejs të dedikuar me zbatim të lehtësuar të standardeve të vazhdueshmërisë për të cilin nuk zbatohen kërkesat nga pika 50) e këtij vendimi, duhet ta plotësojnë këtë:



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

- pajtueshmëri me kërkesat e interfejsit të dedikuar nga pika 42) deri te pika 46) të këtij vendimi;
- interfejsi i dedikuar të dizajnohet dhe testohet në pajtim me kërkesat nga pika 40) e këtij vendimi;
- interfejsi i dedikuar ka pasur përdorim të gjërë nga ofruesit e shërbimeve pagesore gjatë shërbimeve të dhënies së informatave të llogarisë pagesore, për inicim të pagesave dhe për vërtetim të mjeteve të disponueshme të pagesave me kartela pagesore, në periudhë prej së paku tre muajve;
- të gjitha problemet të cilat janë paraqitur në funksionimin e interfejsit të dedikuar janë tejkaluar pa anulim të pa arsyeshëm.

Ofruesi i shërbimeve pagesore i cili i mban llogaritë pagesore është i obliguar me kërkesë të Bankës Popullore, të sigurojë vërtetim për plotësimin e kërkesave nga paragrafi (1) i kësaj pike, në pajtim me kahjet e Aneksit nr. 6, Aneksit nr. 7 dhe Aneksit nr. 8, në shtojcë të këtij vendimi.

53. Nëse ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët i mbajnë llogaritë pagesore nuk i plotësojnë në tërësi kërkesat nga pika 52) në periudhë më të gjatë se 2 javë kalendarike të njëpasnjëshme, ato janë të obliguar në afat sa më të shkurtër të mundshëm dhe më së voni në afat prej 2 muajve, të vendosin procedura për zbatimin e standardeve të vazhdueshmërisë nga pika 50) e këtij vendimi.

Certifikata

54. Për nevojat e identifikimit nga pika 36), paragrafi (1), nënparagrafi (1) i këtij vendimi, ofruesit e shërbimeve pagesore përdorin certifikate të kualifikuara për vulë elektronike ose certifikatë të kualifikuar për autentifikim të internet faqes, në pajtim me Ligjin e Dokumenteve Elektronike, Identifikim Elektronik dhe Shërbime Konfidenciale.

55. Certifikatat e kualifikuara për vula elektronike dhe për autentifikim të internet faqes nga pika 54) të këtij vendimi përfshijnë gjuhë të kuptueshme ndërkombëtarisht shenja specifike për secilën nga këto norma:

- lloji i ofruesit të shërbimeve pagesore i cili mund të ketë një ose më shumë nga këto role: mirëmbajtja e llogarisë pagesore; inicimi i pagesave; dhënia e informacione të llogarive pagesore; lëshimi i instrumenteve pagesore të bazuara në kartela;
- numri i regjistrimit të ofruesit të shërbimeve pagesore nga regjistri i institucioneve pagesore dhe emri i organit kompetent ku është regjistruar ofruesi i shërbimeve pagesore.

56. Tiparet e pikës 55) të këtij vendimi nuk ndikojnë mbi ndërveprueshmërinë dhe vlefshmërinë e certifikateve të kualifikuara të vulave elektronike ose për autentifikim të internet faqes.

Siguria në kanalin e komunikimit

57. Ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët mbajnë llogari pagesore, ofruesit e shërbimeve pagesore për lëshim të instrumenteve pagesore të bazuara në kartela, ofruesit e shërbimeve



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

për dhënie të informacioneve të llogarive pagesore dhe ofruesit e shërbimeve të inicimit të pagesave gjatë shkëmbimit të të dhënave në distancë nëpërmjet të gjitha palëve të përfshira në kanalin e komunikimit zbatojnë enkriptim të sigurtë, duke përdorur standarde të pranura industrialisht, për mbrojtje të konfidencialitetit dhe integritetit të të dhënave.

58. Ofruesit e shërbimeve për lëshim të instrumenteve pagesore të bazuara mbi kartela, ofruesit e shërbimeve për dhënie të informacioneve të llogarive pagesore dhe ofruesëve të shërbimeve të inicimit të pagesave janë të obliguar ta mbajnë kohëzgjatjen e kanalit të komunikimit i cili është i mundur nga ofruesit e shërbimeve pagesore, të cilët i mbajnë llogaritë pagesore, sa më shkurt që është e mundur dhe në mënyrë aktive ta ndërprejnë kanalin e tillë menjëherë pas mbarimit të aktivitetit të kërkuar.
59. Në rast të kanaleve paralele të komunikimit me ofruesin e shërbimeve pagesore i cili i mban llogaritë pagesore, ofruesit e shërbimeve të inicimit të pagesave dhe ofruesëve të shërbimeve të dhënies së informacioneve të llogarive pagesore, mundësojnë lidhjen e tyre të sigurtë me kanalin relevante përkatës të komunikimit me përdoruesit e shërbimeve pagesore, që të ndalohet mundësia porositë ose informacionet të cilat shkëmbehen mes tyre të drejtohen gabimisht.
60. Në komunikim me ofruesin e shërbimeve pagesore i cili e mban llogarinë pagesore, ofruesit e shërbimeve për dhënie të informacioneve të llogarive pagesore, ofruesit e shërbimeve për inicim të pagesave dhe ofruesit e shërbimeve pagesore që lëshojnë instrumente pagesore të bazuara në kartela i sigurojnë këto elemente:
- përdoruesit e shërbimeve pagesore dhe kanalin përkatës të komunikimit, që të bëhet dallim mes kërkesave të ndryshme nga përdoruesit e njëjtë të shërbimeve pagesore;
 - identifikim unik të transaksionit pagesor të inicuar, gjatë përdorimit të shërbimeve të inicimit të pagesave;
 - identifikim unik të kërkesës për vërtetim të disponueshmërisë së shumës së fondeve, për ekzekutimin e transaksionit të pagesës me kartelë.
61. Ofruesit e shërbimeve të cilët i mbajnë llogaritë pagesore, ofruesit e shërbimeve të dhënies së informacioneve të llogarive pagesore, ofruesit e shërbimeve për inicim të pagesave dhe ofruesëve të llogarive pagesore që lëshojnë instrumente pagesore të bazuara në kartela, gjatë transmetimit të tipareve të sigurisë së përdoruesit dhe kodeve të autentifikimit, sigurojnë që ato të mos jenë direkt ose indirekt të lexueshme nga asnjë punonjës i tyre, në asnjë moment.
- Në rast të shkeljes së vërtetuar të konfidencialitetit të tipareve të sigurisë së përdoruesit në kompetencë të ofruesëve të shërbimeve pagesore të theksuara në paragrafin (1) të kësaj pike, ato pa anulim të panevojshëm e informojnë përdoruesin e shërbimeve pagesore dhe lëshuesin e tipareve të sigurisë së përdoruesit.

Shkëmbimi i të dhënave

62. Ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët i mbajnë llogaritë pagesore i plotësojnë këto kërkesa:
- Ofruesëve të shërbimeve të llogarive pagesore iu japin informacionet e njëjta për llogaritë pagesore të caktuara dhe transaksionet pagesore të cilat janë të lidhura me



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

- ato dhe të cilat përdoruesit të shërbimeve pagesore janë të disponueshme onlajn dhe nuk përmbajnë të dhëna të ndjeshme të pagesave;
- menjëherë pas pranimi të urdhërpagesës, ofruesëve të shërbimeve për inicim të pagesave iu japin të njëjtat informacione të inicimit të pagesave dhe zbatimin e transaksionit pagesor, i cili i është dhënë ose ju kanë venduar në dispozicion përdoruesit të shërbimeve pagesore, njëjtë sikur në rastet kur transaksioni ka qenë i inicuar direkt nga përdoruesi i shërbimeve pagesore;
 - me kërkesë të ofruesëve të shërbimeve pagesore, menjëherë edhe me konfirmim të thjeshtë me "po" ose "jo", ju konfirmohet se a është e disponueshme shuma e nevojshme për ekzekutim të transaksionit pagesor në llogarinë pagesore.
63. Në rast të ngjarjes së paparashikuar ose gabimit gjatë procesit të identifikimit, autentifikimit ose shkëmbimit të të dhënave, ofruesi i shërbimeve pagesore i cili i mban llogaritë pagesore ju dërgon njoftim ofruesëve të shërbimeve për inicim të pagesave, ofruesëve të shërbimeve të dhënies së informacioneve të llogarive pagesore dhe ofruesëve të shërbimeve pagesore të cilët lëshojnë instrumente pagesore të bazuara në kartela, në të cilën shpjegohet arsyja e ngjarjes së paparashikuar ose gabimit.
- Nëse ofruesit të shërbimeve pagesore i cili i mban llogaritë pagesore siguron interfejs të dedikuar në pajtim me pikat 42), 43), 44), 45) dhe 46) të këtij vendimi, interfejsi krijon porosi për ngjarjet nga paragrafi 1 të kësaj pike të cilat ofruesi i shërbimeve pagesore i ka zbuluar dhe është i detyruar t'i dorëzojë tek ofruesit tjerë të shërbimeve pagesore të cilët marrin pjesë në kanalin e komunikimit.
64. Ofruesi i shërbimeve për dhënie të informacione të llogarive pagesore është i obliguar të vendos mekanizma përkatëse dhe efikate me të cilat parandalohet qasja tek informacionet, përveç tek ato të cilat kanë të bëjnë me llogarinë pagesore të caktuar dhe llogaritë pagesore të lidhura me ato për të cilat përdoruesi i llogarisë pagesore ka dhënë pajtim.
65. Ofruesi i shërbimeve për inicim të pagesave janë të obliguar t'ua shërbejnë ofruesëve të shërbimeve pagesore për mbajtje të llogarive pagesore të njëjtat informacione të cilat i'u kanë kërkuar përdoruesit të shërbimeve pagesore gjatë inicimit direkt të transaksionit pagesor.
66. Ofruesit e shërbimeve për dhënie të informacioneve të llogarive pagesore mund të kenë akses deri te informacionet nga llogaritë pagesore të caktuara dhe transaksioneve pagesore të lidhura me ato, të cilat mbahen nga ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët i mbajnë llogaritë pagesore, në ndonjë nga këto raste:
- kur përdoruesi i shërbimit pagesor i kërkon ato informacione;
 - kur përdoruesi i shërbimit pagesor nuk i kërkon në mënyrë aktive ato informacione, jo më shumë se katër herë gjatë 24 orëve, përveç nëse nuk është rënë dakord për frekuencë më të madhe mes ofruesit të shërbimeve të dhënies së informacioneve të llogarive pagesore dhe ofruesit të shërbimeve pagesore i cili i mban llogaritë pagesore, në pajtim me përdoruesin e shërbimeve pagesore.



VII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

67. Ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët janë të themeluar në ditën e zbatimit të këtij vendimi janë të obliguar ta përshtatin funksionimin e tyre me kërkesat e këtij vendimi jo më vonë se 19 shkurt 2024.

Me përjashtim të paragrafit (1) të kësaj pike, ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët janë themeluar në ditën e zbatimit të këtij vendimi dhe të cilët i mbajnë llogaritë pagesore janë të obliguar:

- të sigurojnë platformë teknike dhe mbështetje, për testim të lidhjes dhe funksionaliteteve të interfejsit, në pajtim me pikën 40 të këtij vendimi dhe vërtetim të përshtatshmërisë së kërkesave ligjore në lidhje me dizajnin e interfejsit të dedikuar dhe rezultateve totale nga testi, në pajtim me kahjet e Aneksit nr. 6, në shtojcë të këtij vendimi, së paku 5 muaj para datës së përshtatjes së funksionimit të tij me kërkesat e këtij vendimi, por jo më vonë se 30 shtator 2023;
- të dorëzojnë raport se interfejsi i dedikuar nuk krijon pengesa gjatë sigurimit të shërbimeve të inicimit të pagesave dhe shërbimeve për dhënie të informacioneve të llogarive pagesore, së paku 2 muaj para datës së përshtatjes së funksionimit të saj me kërkesat e këtij vendimi, por jo më vonë se 31 dhjetori 2023;
- të dorëzojnë raport të përmbledhur nga rezultatet e stres testimit të rezistencës, si dhe informacionet e mënyrës me të cilat janë tejkaluar dobësitë e identifikuar, së paku një muaj para datës së përshtatjes së funksionimit të saj me kërkesat e këtij vendimi, por jo më vonë se 31 janar 2024.

68. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tete nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

V nr.02-15/XXII-7/2022
28 dhjetor 2022
Shkup

Guvernatorja dhe
kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска



Shtojca:

Aneks nr.1	-	"Normat referuese të mashtrimit"
Aneks nr.2	-	"Ndjekje të disponueshmërisë dhe efikasitetit të interfejsit të dedikuar"
Aneks nr.3	-	"Publikimi i të dhënave statistikore"
Aneks nr.4	-	"Strestestimi i rezitencës"
Aneks nr.5	-	"Raport se interfejsi i dedikuar nuk krijon pengesë"
Aneks nr.6	-	"Dizajnim dhe testim i interfejsit të dedikuar"
Aneks nr.7	-	"Përdorim i gjërë i interfejsit të dedikuar"
Aneks nr.8	-	"Informacion për tejkalimin e problemeve"



Aneks nr.1

“Normat referuese të mashtrimit”

Normat referuese të mashtrimit në %		
Vlera e pragut të përjashtimit (në denarë)	Transaksione pagesore elektronike me instrument pagesore të bazuar mbi kartelë	Transfere kreditore elektronike
deri 30.000	0,01	0.005
deri 15.000	0,06	0,01
deri 6000	0,13	0.015



Aneksi nr. 2

“Ndjekja e disponueshmërisë dhe e efikasitetit të interfejsit të dedikuar”

1. Ofruesit e shërbimeve pagesore të cilat i mbajnë llogaritë pagesore janë të obliguar, për nevojat e ndjekjes së disponueshmërisë dhe efikasitetit të interfejsit të dedikuar, t'i definojnë së paku këto tregues kyç:
 - Koha e funksionimit të qetë të interfejsit të dedikuar në bazë ditore (ang. uptime per day);
 - Koha e padisponueshmërisë së interfejsit të dedikuar në bazë ditore (ang. downtime per day);
 - Koha mesatare ditore e inicimit të pagesave;
 - Koha mesatare ditore e dhënies së informacioneve të llogarive pagesore;
 - Koha mesatare ditore e nevojshme për vërtetimin e kërkuar në format “po” ose “jo” nga ofruesi i shërbimeve pagesore për lëshim të instrumenteve të bazuara mbi kartela;
 - Norma ditore e përgjigjeve të gabuara të dorëzuara (ang. error response rate).
2. Për llogaritjen e treguesëve të disponueshmërisë dhe efikasitetit të interfejsit të dedikuar nga pika 1 e këtij aneksi, ofruesit e shërbimeve pagesore të cilët i mbajnë llogaritë pagesore janë të obliguar:
 - Kohën e funksionimit të qetë ta llogarisin si diferencë mes 100% dhe kohës së padisponueshmërisë;
 - Kohën e padisponueshmërisë ta llogarisin, në përqindje, si numër total të sekondave të padisponueshmërisë të interfejsit të dedikuar të definuar me pikën 3 nga ky aneks në periudhë prej 24 orëve (të shprehur në sekonda) ku mesnata është fillimi dhe fundi i periudhës;
 - Koha mesatare ditore e inicimit të pagesave (e shprehur në milisekonda) llogaritet si koha totale e dorëzimit të informacioneve në pajtim me pikën 62), paragrafin (1), nënparagrafin (2) të këtij vendimi, të ndarë me numrin e kërkesave të tilla në periudhën prej 24 orëve, ku mesnata është fillimi dhe fundi i periudhës;
 - Koha mesatare e dhënies së informacioneve të llogarive pagesore (e shprehur në milieskonda) llogaritet si koha totale e dorëzimit të informacioneve në pajtim me pikën 62), paragrafin (1), nënparagrafin (1) të këtij vendimi, të ndarë me numrin e kërkesave të tilla në periudhë prej 24 orëve, kur mesnata është fillimi dhe fundi i periudhës;
 - Koha mesatare ditore e nevojshme për vërtetimin e kërkuar në format “po” ose “jo” nga ofruesi i shërbimeve pagesore për lëshim të instrumenteve të bazuara mbi kartela (të shprehur në milisekonda), llogaritet si koha totale e dorëzimit të informacioneve në pajtim me pikën 62), paragrafi (1), nënparagrafi (3) i këtij vendimi, të ndarë me numrin e kërkesave të tilla në periudhë prej 24 orëve, ku mesnata është fillimi dhe fundi i periudhës;
 - Normën ditore të përgjigjeve të gabuara ta llogarisin si numër të përgjigjeve të gabuara të dorëzuara gjatë ditës nga ofruesi i shërbimeve pagesore, i cili i mban llogaritë pagesore nga ofruesit e shërbimeve për inicim të pagesave, ofruesëve të shërbimeve të dhënies të informacioneve të llogarive pagesore dhe ofruesëve të shërbimeve pagesore për lëshim të instrumenteve pagesore të bazuara mbi kartela të



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

ndarë me numrin total të kërkesave të dorëzuara gjatë ditës nga ofruesit e listuar më parë.

3. Interfejsi i dedikuar trajtohet si i padisponueshëm kur në pesë shërbimet e njëpasnjëshme të inicimit të pagesave, shërbimeve për dhënie të informacione të llogarisë pagesore ose vërtetimit të shumës së disponueshme të fondeve, interfejsi nuk do të përgjigjet në afat prej 30 sekondave, pavarësisht se kërkesat janë të drejtuara deri te një ose më shumë ofrues të shërbimit për inicim të pagesave, ofrues të shërbimit të dhënies së informacioneve të llogarive pagesore dhe ofruesëve të shërbimeve pagesore për lëshim të instrumenteve pagesore të bazuara mbi kartela.

Ofruesi i shërbimit pagesor i cili i mban llogaritë pagesore e llogarit kohën e padisponueshmërisë nga momenti i kërkesës së parë në rendin e pesë kërkesave të njëpasnjëshme në të cilat nuk është përgjigjur në afat prej 30 sekondave, nëse në periudhën e pesë kërkesave nuk ka pasur asnjë kërkesë në të cilën është përgjigjur me sukses.



Aneksi nr. 3

“Publikimi i të dhënave statistikore”

1. Ofruesi i shërbimeve pagesore i cili i mban llogaritë pagesore është i obliguar në faqen e tij publike të internetit ta vendos në disponim planin tremujor të të dhënave statistikore ditore të disponueshmërisë dhe efikasitetit të interfejsit të dedikuar dhe të interfejsave të cilat përdoren nga përdoruesit e shërbimeve pagesore për qasje deri te llogaritë e tyre pagesore, direkt, onlajn.
2. Gjatë publikimit të planit, ofruesi i shërbimit pagesor i cili i mban llogaritë pagesore e thekson edhe internet faqen e publikimit të të dhënave statistikore, si dhe datën e publikimit të tyre të parë.
3. Në bazë të publikimit të të dhënave statistikore, ofruesit e shërbimeve për inicim të pagesave, ofruesëve të shërbimeve për dhënie të informacioneve të llogarive pagesore dhe ofruesëve të shërbimeve pagesore për lëshim të instrumenteve pagesore të bazuara mbi kartela në bazë ditore i përdorin për krahasim të disponueshmërisë dhe efikasitetit të interfejsit të dedikuar të disponueshmërisë dhe efikasitetit të interfejsave të cilat ofruesi i shërbimeve pagesore i cili i mban llogaritë pagesore i vën në disponim përdoruesëve të shërbimeve pagesore për qasje deri te llogaritë pagesore direkt, onlajn.



Aneks nr.4

“Stres testimi i rezitencës”

1. Ofruesi i shërbimeve pagesore i cili i mban llogaritë pagesore është i obliguar të zbatojë, në çdo tre vjet, stres testim përkatës të rezistencës së interfejsit të dedikuar dhe atë për:
 - aftësia e tij që t’ju mundësojë qasje më shumë ofruesëve të shërbimeve pagesore për inicim të pagesave, ofruesëve të shërbimeve për dhënie të informacione të llogarive pagesore dhe ofruesëve të shërbimeve pagesore për lëshim të instrumenteve pagesore të bazuara mbi kartela,
 - aftësia e tij me sukses të përpunojë, në afat të shkurtë kohor, një numër jashtzakonisht të madh të kërkesave të marra nga ofruesit e shërbimeve për inicim të pagesave, ofruesëve të shërbimeve për dhënie të informacione të llogarive pagesore dhe ofruesëve të shërbimeve pagesore për lëshim të instrumenteve pagesore të bazuara mbi kartela,
 - përdorimi i tij nga numri jashtzakonisht i madh i kanaleve të komunikimit për inicim të pagesave, dhënie të informacioneve të llogarive pagesore dhe vërtetim të disponueshmërisë së shumës së fondeve, të vendosura në të njejtën kohë; dhe
 - aftësia e tij që në mënyre përkatëse t’u përgjigjet kërkesave për sasi të mëdha të dhënash.



Aneksi nr. 5

“Raportoni se ndërfejsi i dedikuar nuk shkakton përçarje”

1. Ofruesi i shërbimeve pagesore që mirëmban llogaritë pagesore përgatit raport që ndërfejsi i dedikuar nuk krijon ndërprerje, që përmban:
 - informacion përmbledhës rreth metodave të mbështetura nga ndërfejsi i dedikuar dhe që zbatohen në procedurat e vërtetimit të përdoruesit të shërbimeve pagesore, respektivisht metodat e ridrejtimit (angl. redirection), të shkëputjes (angl. decoupled), të lidhjes (angl. embedded) ose kombinimi i tyre;
 - shpjegimi i arsyeve përse metodat e zbatuara në procedurën e vërtetimit të përdoruesit të shërbimeve pagesore nuk trajtohen si pengesë dhe mënyrat se si ofruesit e shërbimeve që iniciojnë pagesat dhe ofruesit e shërbimeve të ofrimit të informacioneve rreth llogarive pagesore bazuar në këto metoda mund të mbështeten në procedurat e vërtetimit të ofruara për përdoruesit e tyre të shërbimeve pagesore nga ofruesi i shërbimeve pagesore që mirëmban llogaritë e pagesore;
 - konfirmimi se ndërfejsi i dedikuar nuk është shkak i vonesave ose pengesave të panevojshme gjatë aktiviteteve të përdoruesit gjatë qasjes në llogarinë e tij pagesore nëpërmjet ofruesve të shërbimeve që fillojnë pagesat, ofruesit e shërbimeve të ofrimit të informacionit mbi llogaritë pagesore ose ofruesit e shërbimeve pagesore për lëshimin e instrumenteve pagesore të bazuara në kartelë ose paraqitja e disa shkaqeve të tjera, përfshirë hapa shtesë të panevojshëm ose përdorimin e një gjuhe të paqartë ose të ndërlikuar, për shkak të së cilës përdoruesit e shërbimeve pagesore refuzojnë t'i përdorin shërbimet e ofruesve të shërbimeve që iniciojnë pagesat, ofruesit e shërbimeve të ofrimit të informacionit mbi llogaritë pagesore ose ofruesit e shërbimeve pagesore për lëshimin e instrumenteve pagesore të bazuara në kartelë.
2. Në kuadër të shtojcës nga pika 1), paragrafi (1), nënparagrafi (2) i këtij aneksi, ofruesi i shërbimit pagesor që mban llogaritë e pagesore paraqet konfirmim se:
 - ndërfejsi i dedikuar nuk është pengesë për ofruesit e shërbimeve që nisin pagesat, ofruesit e shërbimeve të ofrimit të informacioneve mbi llogaritë pagesore që të mbështeten dhe të përdorin procedurat e vërtetimit që ofruesi i shërbimit pagesor që mban llogarinë pagesore u ofron përdoruesve të tij në shërbimet pagesore;
 - nuk ka kërkesa ose regjistrime shtesë nga ofruesit e shërbimeve që iniciojnë pagesat, ofruesit e shërbimeve të ofrimit të informacionit mbi llogaritë pagesore ose ofruesit e shërbimeve pagesore për lëshimin e instrumenteve pagesore të bazuara në kartela;
 - ofruesi i shërbimit pagesor që mban llogarinë pagesore nuk realizon kontroll shtesë për pëlqimin që përdoruesi i shërbimeve pagesore u ka dhënë ofruesve të shërbimeve për fillimin e pagesave ose të ofruesve të shërbimeve të informacionit të llogarisë pagesore për të qasur informacionin e llogarisë pagesore të mbajtura nga ofruesi i shërbimit pagesor, ose për të filluar pagesat, dhe
 - nuk realizohet verifikim i pëlqimit të dhënë nga përdoruesi i shërbimeve pagesore të ofruesit të shërbimeve pagesore për lëshimin e instrumenteve pagesore me kartelë, për të konfirmuar disponueshmërinë e shumës së mjeteve.



Aneksi nr. 6

“Dizajnimi dhe testimi i interfejsit të dedikuar”

1. Ofruesit e shërbimeve pagesore që mbajnë llogarinë pagesore janë të detyruar të kërkesën për konfirmimin e pajtueshmërisë me kërkesat ligjore në lidhje me dizajnin e ndërfaqes së dedikuar, t'i dorëzojnë Bankës Popullore:
 - vërtetim që interfejsi i dedikuar i plotëson kërkesat rregullatore për qasje në llogarinë pagesore dhe shkëmbimin e të dhënave, e cila përfshin: dokumentacion teknik, përshkrim të funksionalitetit të tij dhe shpjegim se si zbatimi i tyre plotëson kërkesat rregullatore, dhe
 - informacion mbi atë se nëse dhe në çfarë mënyre është krijuar bashkëpunimi i ofruesit të shërbimit pagesor që mban llogarinë pagesore me ofruesit e shërbimeve të fillimit të pagesës, ofruesit e shërbimeve të informacionit të llogarisë pagesore dhe ofruesit e shërbimeve pagesore të lëshimit të instrumenteve pagesore të bazuara në kartelë.
2. Ofruesi i shërbimit pagesor që mban llogarinë pagesore, është i detyruar të vërë në dispozicion dokumentacionin teknik gjatë testimit të interfejsit të dedikuar për interfejsin e dedikuar të ofruesve të shërbimeve, që nisin pagesat ofruesit e shërbimeve të informacionit të llogarisë pagesore dhe ofruesit e shërbimeve pagesore të lëshimit të instrumenteve të pagesave të bazuara në kartelë, të cilat janë regjistruar në regjistrin e institucioneve pagesore ose të ofruesit të shërbimeve pagesore, që ka paraqitur kërkesë për marrjen e licencës për ofrimin e shërbimeve pagesore.
3. Ofruesit e shërbimeve pagesore që mbajnë llogarinë pagesore, ofruesve të shërbimeve që nisin pagesat, ofruesit e shërbimeve të informacionit të llogarisë pagesore dhe ofruesit e shërbimeve pagesore të lëshimit të instrumenteve pagesore të bazuara në kartelë, të cilat janë regjistruar në regjistrin e institucioneve pagesore ose ofruesi i shërbimit pagesor, që ka paraqitur kërkesë për licencë për ofrimin e shërbimeve pagesore është i detyruar t'u sigurojë atyre platformë të testimit, d.m.th. interfejsi i dedikuar të testohet në mjedis të sigurt, të veçuar në të cilin nuk përdoren të dhëna reale të përdoruesit të shërbimeve pagesore dhe që do të verifikojë të paktën:
 - kanalet e sigurta të komunikimit, të qëndrueshme dhe të besueshme;
 - sigurimin e shkëmbimit të certifikatave përkatëse të kualifikuara ndërmjet ofruesve të shërbimeve pagesore që mbajnë llogarinë pagesore dhe ofruesit e shërbimeve që nisin pagesat, ofruesit e shërbimeve të ofrimit të informacionit mbi llogaritë pagesore dhe ofruesit e shërbimeve pagesore që lëshojnë instrumente pagesore të bazuara në kartela, të cilat janë të regjistruara në regjistrin e institucioneve pagesore;
 - ofrimin e dërgesave dhe pranimin të mesazheve për gabim;
 - ofruesit e shërbimeve të fillimit të pagesës mund të dërgojnë urdhëresa për fillimin e pagesës dhe në të njëjtën kohë ofruesit e shërbimeve pagesore që mbajnë



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

- llogarinë pagesore pas marrjes së tyre mund të përgjigjen në pajtueshmëri me rrethanat;
- ofruesit e shërbimeve të informacionit të llogarisë pagesore mund të dërgojnë kërkesa për qasje në të dhënat e përdoruesve të shërbimeve pagesore dhe në të njëjtën kohë ofruesit e shërbimeve pagesore që mbajnë llogarinë pagesore, pas marrjes së tyre mund të ofrojnë informacionin e kërkuar në pajtueshmëri me rrethanat;
 - ofruesit e shërbimeve pagesore të lëshimit të instrumenteve pagesore të bazuara në kartela dhe ofruesit e shërbimeve të fillimit të pagesave, mund të dërgojnë kërkesa për ofruesit e shërbimeve pagesore që mbajnë llogarinë pagesore së cilës i përgjigjen me konfirmim të thjeshtë "po" ose "jo", respektivisht nëse shuma e nevojshme për të realizuar transaksionin pagesor është e disponueshme në llogarinë pagesore;
 - ofruesit e shërbimeve që nisin pagesat dhe ofruesit e shërbimeve të ofrimit të informacionit mbi llogaritë pagesore mund të mbështeten në të gjitha procedurat e vërtetimit të cilat ofruesit e shërbimeve pagesore që mbajnë llogarinë pagesore u ofrojnë përdoruesve të shërbimeve pagesore.
4. Ofruesit e shërbimeve pagesore që mbajnë llogarinë pagesore janë të detyruar, me kërkesë të Bankës Popullore, të dorëzohen rezultatet përmbledhëse të testimit për secilën kërkesë nga pika 3 e këtij aneksi, duke përfshirë numrin e ofruesve të shërbimeve që nisin pagesat, ofruesit e shërbimeve të informacionit të llogarisë pagesore dhe ofruesit e shërbimeve pagesore që lëshojnë instrumente pagesore të bazuara në kartela që kanë përdorur platformën e testimit, informacionet kthyesë që ofruesit e shërbimeve pagesore që mbajnë llogarinë pagesore kanë marrë prej tyre, të dhënat për problemet e identifikuar dhe mënyrat për tejkalimin e tyre.



Aneksi nr.7

“Përdorimi i gjerë i interfejsit të dedikuar”

1. Ofruesit e shërbimeve pagesore që mbajnë llogarinë pagesore janë të detyruar të konfirmojnë përdorimin e gjerë të interfejsit të dedikuar, me kërkesë të Bankës Popullore, të dorëzojnë:
 - përshkrim të përdorimit të interfejsit të dedikuar gjatë periudhës prej të paktën tre muajsh, duke përfshirë edhe: numrin e ofruesve të shërbimeve të fillimit të pagesës, ofruesve të shërbimeve të informacionit të llogarisë pagesore dhe ofruesve të shërbimeve pagesore për lëshimin e instrumenteve pagesore të bazuara në kartela që kanë përdorur interfejsin e dedikuar dhe numrin e kërkesave të paraqitura prej tyre nëpërmjet interfejsit të dedikuar të ofruesit të shërbimeve pagesore që mban llogaritë pagesore, si dhe numrin e atyre të cilëve u është përgjigjur;
 - konfirmim që ofruesi i shërbimit pagesor që mban llogaritë pagesore ka marrë të gjitha masat e nevojshme për përdorimin e gjerë të interfejsit të dedikuar, duke përfshirë publikimin e raporteve mbi disponueshmërinë dhe efektivitetin e tij duke postuar statistika në faqet e internetit dhe rrjetet sociale.



Aneksi nr. 8

“Informacion për tejkalimin e problemeve”

1. Ofruesit e shërbimeve pagesore që mbajnë llogarinë pagesore janë të detyruar, të konfirmojnë masat e marra për tejkalimin e problemeve që kanë lindur në funksionimin e interfejsit të dedikuar, me kërkesë të Bankës Popullore, të dorëzojnë:
 - informacion për sistemet apo procedurat e prezantuara për mbikëqyrje, zgjidhjen dhe tejkalimin e problemeve të raportuara, në veçanti nga ofruesit e shërbimeve të fillimit të pagesave, ofruesit e shërbimeve të informacionit të llogarive pagesore dhe ofruesit e shërbimeve pagesore të lëshimit të instrumenteve pagesore të bazuara në kartela, dhe
 - shpjegim të problemeve të raportuara nga ofruesit e specifikuar në paragrafin (1), nënparagrafin (1) të kësaj pike të aneksit, të cilat nuk janë tejkaluara në pajtueshmëri me nivelet e përcaktuara të shërbimit.